

Fitim RIFATI

**HASAN PRISHTINA - PERSONALITET
SHUMËDIMENSIONAL GJATË LUFTËS SË PARË
BOTËRORE**

Abstrakt:

Roli i personaliteteve politike në rrethana të ndërlikuara luftime, sikurse përgjatë viteve të Luftës së Parë Botërore, është i rëndësishëm dhe përcaktues në aspekte të veçanta. Në këtë kontekst, edhe për shqiptarët gjatë kësaj luftime ishte i domosdoshëm angazhimi i figurave politike, për të përfaqësuar interesin kombëtar në rrjedhat e politikave shtetërore të Fuqive të Antantës dhe Fuqive Qendrore, që kishin shtrirë pushtimin e tyre në viset shqiptare. Paraqitja e Hasan Prishtinës në skenën e Luftës së Parë Botërore përcaktoi edhe pozicionin e tij, që paraprakisht kishte bazë orientimin politik e diplomatik. Relacionet e tij me Austro-Hungarinë para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore përcaktuan edhe veprimtarinë në suaza të objektivave dhe synimeve reciproke, që u definuan në dy pikëpamje: për një Shqipëri dhe shqiptarë të bashkuar në një shtet kombëtar dhe për një Shqipëri dhe shqiptarë aleatë të Austro-Hungarisë. Ky relacion i ndërsjellë u shoqërua me ngritje dhe rënie, të cilat u manifestuan në disa faza kryesore.

Fjalët kyçe: *Hasan Prishtina, bashkimi, Shqipëria, përparim.*

Politikan, diplomat, organizator i veprimeve të armatosura për çlirim, përkrahës i zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe i emancipimit kulturor e arsimor të shqiptarëve: këto ishin disa nga karakteristikat që e kanë shoqëruar dimensionin e personalitetit të Hasan Prishtinës përgjatë Luftës së Parë Botërore. Mirëpo ato në raste të veçanta kanë prodhuar edhe situata delikate, që në radhë të parë kanë rrezikuar jetën dhe veprimtarinë e tij. Në suaza të këtyre karakteristikave, personalitetin e Hasan Prishtinës përgjatë Luftës së Parë Botërore mund ta analizojmë në tri faza kryesore:

1. Në fazën e parë, nga korriku i vitit 1914 deri në fund të vitit 1915;
2. Në fazën e dytë, nga viti 1916 deri në prill të vitit 1918;
3. Në fazën e tretë, nga maji deri në nëntor të vitit 1918.

Në fazën e parë

Në nëntor të vitit 1912, gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Hasan Prishtina së bashku me veprimtarë e bashkëpunëtorë të tjerë u arrestua në Shkup nga ushtria serbe. Internimi dhe burgosja në Beograd pasoi me presionin dhe kërcënimin serb për t'u deklaruar zyrtarisht, se nuk njohin Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë.¹ Rrjedhimisht, për shkak të presionit ndërkombëtar, veçanërisht atij austro-hungarez, në prill të vitit 1913 u bë lirimi i tyre nga burgu.² Menjëherë pas lirimit shkoi në Shqipëri dhe u angazhua për konsolidimin e shtetit shqiptar dhe çlirimin e trevave shqiptare të pushtuara dhe të aneksuara shteteve fqinje ballkanike.

¹ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëllimi VII (dhjetor), Përgatitja dhe redaktimi: Marenglen Verli, Ledia Dushku, Qendra e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë, Tiranë: "Botimet Albanologjike", 2012, 108-109, telegram i Heimroth nga Shkupi për Berchtold në Vjenë, Shkup 20 dhjetor, 1912.

² *Letërkëmbime të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, përgatitën Skënder Blaka, Ismail Ismaili, Prishtinë: "Arbi Ltd", 2014, 645-646, *Tri dokumente të lirim të Hasan Prishtinës*, Nexhip Dragës, Idriz Seferit e 11 prijësve të tjerë të internuar në Kështjellën e Beogradit, mars-prill 1913.

Lufta e Parë Botërore e gjeti Hasan Prishtinën në Durrës përkrah Princ Vilhelm Vidit, të përkushtuar në ndërtimin dhe zhvillimin institucional e shtetëror të Shqipërisë. Atentati i Sarajevës dhe fillimi i Luftës së Parë Botërore ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Serbisë përshpejtoi aspiratat e Hasan Prishtinës për rifillimin e përpjekjeve të armatosura për çlirimin e trevave shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Shpejt ra në kontakt me përfaqësues të qarqeve diplomatike e ushtarake austro-hungareze, për t'u dëshmuar gatishmërinë e tij dhe të përkrahësve për veprime të armatosura kundër ushtrisë serbo-malazeze. Kësisoj, në takimin e zhvilluar në Kashtel Novi me palën austro-hungareze u shqyrtua mundësia e sulmit të përbashkët kundër ushtrive serbo-malazeze. Qëllimi i Hasan Prishtinës ishte të pranonte garancitë e Vjenës zyrtare për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë pas çlirimit të saj.³ Në gjurmë të aktivitetit të tij ishte Shërbimi Informativ i Serbisë, që ushtronte presion të vazhdueshëm ndaj familjes së tij në Kosovë, me synim neutralizimin e përpjekjeve të tij në dëm të interesave të politikës serbe.

Hasan Prishtina, pa llogaritur mirëfilli potencialin luftarak shqiptar, synonte medoemos të organizonte kryengritje të armatosura në Kosovë, pavarësisht përparimit të ushtrisë austro-hungareze në drejtim të trevave shqiptare. Më 25 korrik 1914, sipas një telegrami sekret të konsullit austro-hungarez në Shkodër, August Kral, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Hasan Prishtina po planifikon “... që të shkoj në mënyrë të fshehtë me anë të Shkodrës në Dibër dhe Lumë, për të përgatitur një forcë të madhe luftuese. Propozimi i tij është shumë serioz dhe meriton konsideratën më të madhe”. Ai iu përmbajt këtij qëndrimi që nga fillimi i Luftës së Parë Botërore.⁴ Mirëpo, përgjatë gjysmës së dytë të vitit 1914, përpjekjet

³ Fatmira Musaj, *Isa Boletini (1864-1916)*, ribotim, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Instituti i Historisë, 2015, 194.

⁴ *Haus - Hof und Staats Archiv, Politisches Archiv Albanien (HHStA, PA, A)*, Wien (më tej: AIHT), Fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës për vitet 1913-1918, që ruhen në Arkivin e Institutit të Historisë dhe në Arkivin Qendror të Shtetit,

për të organizuar një kryengritje të armatosur kundër ushtrive serbo-malazeze dështuan për arsye të ndryshme.

Në fillim të vitit 1915, një valë të arratisurish shqiptarë, për shkak të masave të dhunshme të mobilizimit dhe rekrutimit në kuadër të ushtrisë serbe, nga Kosova u strehuan afër zonës kufitare në Lumë. Hasan Prishtina e konsideroi si moment të favorshëm angazhimin e tyre për të sulmuar ushtrinë serbe⁵, por paraprkishtë dështoi të bindte krerët kryesorë në këtë synim. Sipas informacioneve të shërbimeve të diplomacisë austro-hungareze, *“Hasan Beu pa u marrë vesh me krerët e Lumës e të Dibrës, gjithashtu pa u marrë vesh me Bajram Currin e Isa Boletinin, pa pasur të lidhur besën me askënd, deshi të futet në Prizren, vetëm me të ikurit. Kështu, tërë ndërmarrjes i mungoi çdo organizim e përgatitje me plan. E në këtë mënyrë edhe përfundimi do të ishte patjetër fatqë”*.⁶ Qëndrimi i matur i Isa Boletinit, Bajram Currit etj., gjendja e rëndë e shqiptarëve në Kosovë dhe mungesa e përkrahjes së jashtme, ishin faktorë të rëndësishëm dhe përcaktues të dështimit të këtij synimi, por për Hasan Prishtinën në atë kohë këta faktorë merreshin parasysh pjesërisht.

Ai iu deklaroi qarqeve diplomatike austro-hungareze, se kryengritja e armatosur po ndërmerrej papritur, për shkak të peripecive dhe gjendjes së padurueshme të mijëra të shpërngulurve nga Kosova në Lumë. Duke bërë përpjekje për arsyetimin dhe zgjerimin gjeografik të saj, ai vlerësoi që, në rast se shqiptarët do të sprapseshin nga ushtria serbe, atëherë “një kryengritje e dytë përjashtohet në një kohë të afërme”.⁷ Rrjedhimisht, në shkurt të vitit 1915, Hasan Prishtina u priu mijëra shqiptarëve të armatosur lehtë dhe

Tiranë, Vj.24-35-3586, telegram sekret i konsullit austro-hungarez në Durrës, Kral, dërguar MPJ-së në Vjenë, Durrës, 25 korrik 1914.

⁵ Po aty, Vj.25-4-469, nr. 40, telegram sekret i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ në Vjenë, Shkodër, 15 shkurt 1915.

⁶ Po aty, Vj.25-4-456, nr. 161, telegram nga Vjena dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, Vjenë, 18 shkurt 1915.

⁷ Po aty, Vj.25-4-469, nr. 40, telegram sekret i konsullit austro-hungarez në Shkodër, Halla, dërguar MPJ-së në Vjenë, Shkodër, 15 shkurt 1915.

pjesërisht pa armë, municione dhe ushqime, të cilët ndërmorën një mësymje të furishme nga Ohri deri në rrethinën e Prizrenit, ku arritën të godisnin e të dëbonin rojat kufitare serbe dhe të çlironin disa fshatra.⁸ Mirëpo kundërsulmi i ushtrisë serbe ishte i shpejtë dhe i organizuar mirë, saqë Hasan Prishtina mezi arriti të shpëtonte me ndihmën e një numri bashkëluftëtarësh, duke kaluar lumin Drin në drejtim të Hasit.⁹

Rrjedhimisht, në dallim nga kryengritja e vitit 1912, ku ai ishte drejtues i saj politik, në kryengritjen e vitit 1915 si udhëheqës luftarak nuk shënoi rezultate të dëshirueshme. Përkundrazi, kjo kryengritje u interpretua nga Serbia dhe Mali i Zi si agresion i shtetit shqiptar ndaj territorit të tyre dhe u përdor për marshimin e ushtrisë serbe e malazeze në Shqipëri.¹⁰ Megjithëkëtë, edhe në muajt pasues Hasan Prishtina tregoi gatishmërinë e tij për të organizuar aksione të armatosura kundër ushtrisë serbe e malazeze në zonën kufitare, madje edhe gjatë tërheqjes së tyre nëpër viset shqiptare. Sipas një letre të tij dërguar më 20 prill 1915 konsullit austro-hungarez në Shkodër, August Kral, ndër të tjera theksonte: *“Si shqiptar i vërtetë, unë jam besnik ndaj Austro-Hungarisë, ashtu si dhe austriaku më besnik”*.

Duke kërkuar përkrahjen e natyrshme të Vjenës zyrtare, ai deklaronte se në dallim nga kryengritja e shkurtit 1915, e cila sipas tij “e ka ngritur shumë moralin dhe besimin” e shqiptarëve, në vijim operacionet luftarake të udhëhequra nga ai do të organizoheshin më mirë dhe do të kishin sukses. Mirëpo ai ishte i bindur dhe konkludonte

⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: “Toena”, 2007, 434.

⁹ Богумил Храбак, “Стање на српско-албанској граници и побуна арбанаца на Косову и у Македонији”, në *Зборник радова*, књига 4 (Србија 1915. године), Београд: Историјски Институт, 1986, 66; Tafil Boletini, *Kujtime - Pranë Isa Boletinit & përballë sfidave të kohës*, botim i dytë me 200 ilustrime, përshtatja, përgatitja për botim dhe ilustrimet nga Marenglen Verli, Tiranë: “Botimpex”, 2003, 183-184.

¹⁰ Vebi Xhemaili, *Shqiptarët e Pollogut në luftën për çlirim e bashkim kombëtar 1912-1918*, ribotim, Tetovë 2008, 216.

se, “*për t’i mbajtur njerëzit të gatshëm për një sulm, prania ime (e Hasan Prishtinës, F. R.) në kufi është e domosdoshme*”.¹¹

Në fazën e dytë

Pushtimi i viseve shqiptare nga Fuqitë Qendrore të Bullgarisë dhe Austro-Hungarisë në tetor-dhjetor 1915 vlerësohej nga Hasan Prishtina si mundësi e respektimit prej tyre të perspektivës dhe të drejtave kombëtare e politike të shqiptarëve. Ai prej vitesh ishte futur në anale të politikës dhe të diplomacisë austro-hungareze. Në këtë kontekst doli me projekte konkrete kombëtare, të cilat në thelb përmbanin zgjidhjen e çështjes dhe të statusit politik të shqiptarëve. Në këtë këndvështrim, ai gëzonte autoritet dhe respekt te qarqet administrative austro-hungareze, duke u angazhuar për amnisti dhe lirin e qindra shqiptarëve nga burgosja dhe internimi.¹²

Në kontekstin e rrjedhave politike dhe ushtarake të Luftës së Parë Botërore, si përfaqësues i mendimit politik përparimtar shqiptar, Hasan Prishtina, duke e konsideruar të pamjaftueshëm rregullimin administrativ të trevave shqiptare të ndara në tri subjekte administrative, u paraqiti qarqeve diplomatike e ushtarake të Austro-Hungarisë një projekt politik të bashkimit të të gjitha viseve etnike shqiptare nën Austro-Hungarinë në një shtet kombëtar shqiptar.

Sipas konsullit austro-hungarez në Shkodër, August Kral, i cili iu referohet sugjerimeve politike të Hasan Prishtinës pas takimit me të, “*...shpallja e pavarësisë së Polonisë nga njëra anë dhe instalimi i një administrate nacionale në Epir nga ana tjetër zgjon një jehonë kolosale në Shqipëri dhe do të ringjallë desideratat nacionale për futjen e të gjitha krahinave të Serbisë së Re dhe Malit të Zi të banuara prej shqiptarëve në territorin e okupacionit tonë në Shqipëri, ashtu edhe kërkesën për zgjerimin e administratës nacionale*”. Midis të

¹¹ AIHT, Vj. 25-3-343, Letër e Hasan bej Prishtinës drejtuar konsullit të Përgjithshëm Kral, Shkodër, 20 prill 1915.

¹² *Po aty*, Vj. 26-18-1809, nr. 1135/Res, Aneks i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez në Shkodër, Kral, dërguar Alfred von Rappaport, Shkodër, 3 dhjetor 1916.

tjerash, sipas tij, *“Hasan Prishtina... shpreson se bashkimi i krahinës së Pejës, Gjakovës, Plavës, Gucisë, Mitrovicës dhe Vushtrrisë me Shqipërinë do të ushtrojë një ndikim të madh mbi përpjekjet për unitet të të gjithë popullit dhe njëfarë presioni mbi Bullgarinë në drejtim të lëshimit të atyre tokave të gjera të okupuara prej saj, që banohen prej një popullsie thjesht shqiptare dhe me të drejtë i takojnë Shqipërisë”*. August Kral thekson se *“ndryshimi i kufijve të territorit tonë administrativ shqiptar megjithëqë ka të gjithë simpatinë, aktualisht varet shumë prej arsyeve të një natyre thjesht ushtarake, të cilat gjatë luftës me çdo kusht duhet të mbeten vendimtare”*.¹³

Realizimi i këtij projekti pasonte me krijimin e një ushtrie shqiptare. Po ashtu, Hasan Prishtina u propozoi organeve ushtarake austro-hungareze, që në kuadër të tyre të krijohej dhe të funksiononte një milici shqiptare. Ai synonte angazhimin e shqiptarëve në radhët e ushtrisë austro-hungareze, për shkak se këto trupa mund t'i përdorte në të ardhmen në përputhje me projektin e tij politik e vizionar për një Shqipëri politike të bashkuar. Në analizën e qarqeve të larta ushtarake austro-hungareze, realizimi i synimeve të tilla politike e administrative *“mund të... shkaktonte mjaft komplikime të ndryshme”* në të ardhmen, prandaj ishte *“i padobishëm”*. Veç të tjerash, sipas tyre, bashkimi kombëtar, që ishte baza kryesore e propozimeve dhe e sugjerimeve politike të Hasan Prishtinës, për qarqet më të larta ushtarake austro-hungareze kishte konsekuenca të kësaj natyre, sepse *“një hap i tillë do të shkaktonte shfaqjen e aspiratave analoge të shqiptarët e rretheve malazeze, respektivisht serbe të Plevljes, Prijepoljes, Novipazarit dhe Mitrovicës, dhe gjithashtu do të çelte rishtas problemin për një konsideratë të veçantë të atyre pjesëve të Sanxhakut që u okupuan ushtarakisht (nga trupat e Austro-Hungarisë, F. R) në mënyrë paqësore”*.

¹³ Po aty, Vj.26-7-747, nr.193/P, Sugjerime politike të Hasan Prishtinës mbi konfiguracionin e Shqipërisë nën okupimin tonë, Kral dërguar baronit Burian në Vjenë, Shkodër, 30 nëntor 1916.

Kryekomanda e Ushtrisë Austro-Hungareze urdhëronte qarqet ushtarake, civile e diplomatike në Shqipëri, që *“në përgjigjen që eventualisht do t’i jepet verbalisht Hasan bej Prishtinës, të vihej gjithashtu në dukje, se për shqiptarët mund të jetë krejtësisht njësoj, nëse ata i janë caktuar administratës së Guvernatorit të Përgjithshëm ushtarak të Beogradit, Cetinës, ose asaj të Korparmatës XIX, pasi parimet e Monarkisë të udhëhequra prej dashamirësisë më të mirë për popullin shqiptar, do të aplikohen në mënyrë të barabartë në të tri territoret”*.

Lidhur me zgjerimin e administratës nacionale, Kryekomanda e Ushtrisë vlerësonte se *“afrimi i vendasve në shërbimin administrativ, që deri më sot është zbatuar në një masë të gjerë, është me të vërtetë maksimumi i asaj që mund t’i jepet në rajonet operative një populli aq të pazhvilluar nga pikëpamja kulturore”*. Ndërsa lidhur me bashkëpunimin e Hasan Prishtinës për rekrutimin e shqiptarëve në radhët e ushtrisë austro-hungareze dhe krijimin e një milicie shqiptare *“...mbetet në kompetencën e Komandës së Korparmatës”* XIX në Shkodër.¹⁴ Mirëpo ai ishte kundër fushatës së rekrutimit të shqiptarëve në radhët e ushtrisë osmane e bullgare.

Pas vdekjes së perandorit Franc Jozefit të Parë, Austro-Hungaria organizoi delegacionin shqiptar të homazheve, i cili arriti në Vjenë në prill të vitit 1917. Midis dhjetëra personaliteteve të shquara dhe elitare shqiptare, delegacionit të homazheve me ftesë iu bashkua edhe Hasan Prishtina, që konsiderohej si personalitet me ndikim të madh në popullsinë shqiptare.¹⁵ Audiencia e delegacionit u mirëprit nga perandori austro-hungarez, Karli I, në pallatin perandorak dhe në kabinetin e ministrit të Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë. Ky delegacion në Vjenë realizoi takime me autoritetet më të larta perandorake, politike, diplomatike dhe ushtarake austro-hungareze,

¹⁴ Po aty, Vj.26-3-394, nr.150, Kopje e një urdhri të Kryekomandës së Ushtrisë Austro-Hungareze drejtuar Komandës së Korparmatës XIX në Shkodër, 10 dhjetor 1916.

¹⁵ Po aty, Vj.27-1-132, nr.77 & 39, Telegram nga Vjena dërguar Storck dhe Kral, Vjenë, 9 prill 1917.

duke marrë me vete premtimin se shteti austro-hungarez ishte i përkushtuar ndaj çështjes së aspiratave shqiptare dhe duke i dhënë veçanërisht rëndësi konsolidimit kombëtar të shqiptarëve për një vetadministrim të ardhshëm.¹⁶

Përshtypjet dhe përvoja e krijuar gjatë qëndrimit në Vjenë i dhanë frymëzim Hasan Prishtinës që të përforconte përpjekjet e tij për realizimin e aspiratave politike e kombëtare. Ai synonte që të binte në kontakt edhe me krerët shqiptarë në zonën e pushtimit bullgar për të organizuar veprime në shërbim të synimeve politike. Duket se aktiviteti i tij kishte rënë në gjurmë të autoriteteve bullgare në Kosovë, të cilat në korrik të vitit 1917 e arrestuan dhe e burgosën në Shkup. Ky akt bëri jehonë të menjëhershme në qarqet diplomatike, në organet administrative e në popullsinë shqiptare dhe nxiti paraqitjen e varianteve të ndryshme mbi shkaqet që çuan në burgosjen e tij.

Në arsyetimin e policisë bullgare theksohej mungesa e dokumenteve të udhëtimit për të kaluar kufirin nga zona e administrimit austro-hungarez në zonën e administrimit bullgar.¹⁷ Megjithëkëtë, Hasan Prishtina, që aspironte për një shtet të pavarur dhe të bashkuar shqiptar, llogaritej si organizatori kryesor i luftës së popullit shqiptar për çlirim nga pushtuesit bullgarë. Prandaj aspiratat kombëtare ishin përdorur si një ndër shkaqet e burgosjes së tij.¹⁸ Mirëpo, pas disa muajsh, ai u arratis nga burgu, por pësoi lëndime trupore.¹⁹

¹⁶ Fitim Rifati, "The Visit of Albanian Homage Delegation in Vienna (April 1917)", *Uluslararası Hakemli Tarih Araştırmaları Dergisi Tarih ve Gelecek Dergisi*, Haziran 2020, Cilt 6, Sayı 2 - *Journal of History and Future*, June 2020, Volume 6, Issue 2, e-ISSN 2458-7672, Türkiye: 2020, 463-467.

¹⁷ Vebi Xhemali, "Hasan Prishtina - një jetë për Shqipërinë etnike", në *Scupi*, nr. 4 (Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës - Konferencë shkencore, 13-14 tetor 2012), Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, 2012, 432.

¹⁸ Ajet Haxhiu, *Hasan Prishtina dhe lëvizja patriotike e Kosovës*, Tiranë: "8 Nëntori", 1968, 127.

¹⁹ Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit, *Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh) 1908-1934*, Përgatitur nga Kujtim Nuro, Nezir Bata, Tiranë: "8

Veç kësaj, Hasan Prishtina organizoi dhe u kujdes për formimin e shoqërisë kulturore-arsimore “Bashkimi”, synimi i së cilës ishte zhvillimi i kulturës dhe i arsimit kombëtar. U kujdes për hapjen dhe funksionimin e shkollave të para shqipe në Kosovë. Me nismën e tij u mbajtën edhe aktivitete mbarëkombëtare arsimore, që bënë jehonë në viset shqiptare.²⁰ Në gjysmën e parë të muajit maj 1918, në Pejë, nën atmosferën e një organizimi dhe programi të veçantë, nisi kremtimi i “Javës së Karlit”, ku merrnin pjesë Hasan Prishtina, Bajram Curri, Qerim Begolli, Bedri Pejani etj.²¹ Gjatë ceremonisë u prezantua në ankand një portret i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, për të cilin pejanët ofruan çmimin 10 000 korona. Mirëpo, me propozimin e Hasan Prishtinës, portreti iu dhurua komunës së Pejës.²²

Në fazën e tretë

Shpresat politike të Hasan Prishtinës dhe krerëve të tjerë shqiptarë ndaj Fuqive Qendrore ishin zbehur. Udhëheqësit më të shquar shqiptarë u mblodhën në Shkodër dhe në kushte klandestiniteti, më 1 maj 1918, formuan Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, i cili veproi në mënyrë të fshehtë deri më 7 nëntor 1918. Qëllimi i këtij Komiteti ishte çlirimi dhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Duke parë që rrjedhat e luftës po çonin në humbjen e Fuqive Qendrore, Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” synonte që realizimi i këtij programi të bëhej nga Fuqitë e Mëdha të Antantës. Në krye të këtij Komiteti u zgjodh Hoxhë Kadri Prishtina, ndërsa Hasan

Nëntori”, 1982, 99, Pjesë nga letra e një bashkëkohësi drejtuar Hoxhë Kadri Prishtinës, 12 dhjetor 1917.

²⁰ Fazli Hajrizi, *Mitrovica dhe Shala e Bajgorës në fokusin e historisë (Ngjarje, personalitete historike, arsimore dhe kulturore)*, Prishtinë: “Libri Shkollor”, 2011, 280.

²¹ *Cetinjer Zeitung*, “Die Karlwoche in Ipek.”, nr. 195, Cetinje, Donnerstag den 27. Juni 1918, 4.

²² *Posta e Shqypnis*, “Ndisija komtare e Pejës - Nji ftyrë e Skanderbegut 10 000 koronë” nr. 47, Shkodër, e mërkurë, 29 maj 1918, 4.

Prishtina ishte një nga anëtarët e tij.²³ Muajt në vijim deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore treguan se Hasan Prishtina nxiti formimin e grupeve të armatosura për çlirimin e viseve shqiptare nga pushtimi.

Veprimtaria e Hasan Prishtinës për ndërtimin dhe konsolidimin shtetëror të Shqipërisë dhe angazhimin e saj deri në luftë të armatosur për çlirimin dhe bashkimin e viseve shqiptare të pushtuara dhe të aneksuara mbretërive ballkanike, përbën synimin e tij kryesor gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Fillimisht si personalitet politik e diplomatik, i gatshëm për t'iu përgjigjur pozitivisht dhe praktikisht ideve të shtetit austro-hungarez për të organizuar shqiptarët në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi, më pas për të udhëhequr kryengritje e aksione të armatosura, për të paraqitur projekte politike e ushtarake, për të nxitur e përkrahur zhvillimin dhe përparimin kulturor e arsimor të shqiptarëve deri në humbjen e shpresave politike e diplomatike ndaj Fuqive Qendrore karshi shqiptarëve.

Ndonëse përgjatë viteve të Luftës së Parë Botërore veprimtaria e tij hasi në situata komplekse dhe sfida serioze, angazhimi ekskluziv për bashkim, zhvillim e përparim të shqiptarëve përbën orientimin kryesor, që përjashtoi çdo rrethanë tjetër. Rezultatet e këtij angazhimi kanë shënuar hapa të rëndësishëm historikë e kombëtarë të shqiptarët.

²³ Zamir Shtylla, “Rreth krijimit dhe veprimtarisë së Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës” në vitet 1918-1920”, në *Studime historike*, nr.3, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH - Instituti i Historisë, 1986, 97; Lush Culaj, *Komiteti Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës*, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997, 25-29.